



**Ndërmarrja Publike Komunale "TRAFIKU URBAN" SH. A. Prishtinë**

---

**RREGULLORE NR. 03/2022 PËR PAGAT DHE KOMPENSIME TË TJERA NË  
TRAFIK URBAN SH.A**

Në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 130 të Ligjit Nr. 06-L-016 për Shoqëritë Tregtare, Statutit të Ndërmarrjes Publike Komunale “Trafiku Urban” SH.A. Prishtinë, Rregullores Nr. 01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 26.08.2022 miratoi këtë:

## **RREGULLORE NR. 03/2022 PËR PAGAT DHE KOMPENSIMET TJERA NË TRAFIK URBAN SH.A**

### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregullore është përcaktimi i pagës mujore dhe kompensimeve tjera konform obligimeve dhe përgjegjësi të tyre në kryerjen e detyrave të punës dhe të drejtave për realizimin e të ardhurave nga puna e tyre.

### **Neni 2 Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për të gjithë të punësuarit e Trafikut Urban.

### **Neni 3 Dispozitat e përgjithshme**

1. Me këtë rregullore përcaktohen pagesat mujore dhe kompensimet tjera, konform obligimeve dhe përgjegjësi të tyre në kryerjen e detyrave të punës dhe të drejtave për realizimin e të ardhurave nga puna e tyre.
2. Kjo rregullore është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, politikat e Bordit të Drejtorëve dhe Planin e Biznesit të TRAFIKUT URBAN SH.A

### **Neni 4 Pagesat mujore**

1. Për punën të cilën e kryen punëtori i Trafikut Urban kompensohet me pagë bruto mujore, të përcaktuar sipas Aneksit 1 të kësaj rregullore;
2. Të drejtën për pagë bruto mujore, pagë shtesë, kompensim për punën jashtë orarit, kompensim për punën e natës dhe kompensime tjera të parapara me këtë rregullore, i punësuari i realizon sipas kontratës së punës të nënshkruar me Trafiku Urban dhe legjislacionit në fuqi, për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë;

3. Trafiku Urban obligohet që të përdorë formë të njëjtë të kompensimit për të gjithë të punësuarit.

#### **Neni 5**

#### **Kriteret për përcaktimin e pagës bazë**

1. Paga mujore është e përcaktuar në bazë të kriterëve përcaktuesë siç janë:
  - 1.1. Kualifikimi shkollor i nevojshëm për vendin e punës;
  - 1.2. Ndërlíkueshmëria dhe përgjegjësia e punës në pozitën përkatëse;
  - 1.3. Rëndësia e pozitës sipas përgjegjësisë në procesin e punës;
  - 1.4. Rrezikshmëria në punë e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi;
  - 1.5. Kushtet dhe vëllimi i punës;
  - 1.6. Kualifikimet specifike për pozitat e caktuara;
2. Kriteret e lartcekura, vlerësohen sipas niveleve të përcaktuara me rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës.

#### **Neni 6**

#### **Tabela e kategorizimit**

Tabela e kategorizimit të pagave për vendet e punës është e përcaktuar me Aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 7**

#### **Pagesa mujore**

1. Paga mujore paguhet së paku një herë në muaj dhe këtë më së largu deri më datën 5 të muajit vijues ardhshëm, përveç në rastet kur ndërmarrja mund të ketë probleme financiare;
2. Punëdhënësi duhet të nënshkruajë një raport për listën e çdo pagese shtesë tjetër të paguar të punësuarve, përveç pagës bazë;
3. Pagat e punëtorëve paguhen përmes transferit bankar, ndërsa regjistrat mbi pagesat e bëra i mban punëdhënësi;
4. Në çdo rast punëtori sipas kërkesës së tij mund të merr edhe dëshminë me të dhënat mbi pagën mujore.

## **Neni 8**

### **Praktikantët me pagesë**

Për punëtorët të cilët themelojnë marrëdhënie pune në cilësi të praktikantit, paga mujore për kohën sa gjendet në stazhin e praktikantit është në lartësi prej 50 % të pagës bazë të përcaktuar për vendin e punës për të cilin ka themeluar marrëdhënie pune.

## **Neni 9**

### **Praktikantët pa pagesë**

1. Trafiku Urban në marrëveshje me persona fizik apo juridik mund të angazhojë praktikantë pa ndonjë kompensim të pagës dhe të drejtave të tjera nga marrëdhënia e punës, përveç që duhet të ofrojë mbrojtje dhe siguri në vendin e punës sipas ligjit;
2. Punëdhënësi i cili e angazhon praktikantin pa kompensim page, është i obliguar ta evidentojë praktikantin në listën e evidencave pa kompensim page;

## **Neni 10**

### **Puna provuese**

1. Punëtori i cili ka themeluar marrëdhënie pune të rregullt në një pozitë të cilën nuk e ka ushtruar më parë, është i obliguar që të kalojë nëpër punën provuese;
2. Gjatë punës provuese, punëtori merr pagën e plotë mujore, të paraparë për atë vend pune;
3. Puna provuese përfshin periudhën prej tre muajsh dhe e njëjta vlerësohet me shkrim nga eprori përkatës, në rast të vlerësimit negativ, të punësuarit i ndërpritet marrëdhënia e punës me njoftim paraprak prej 7 ditësh.

## **Neni 11**

### **Kompensimi për punën me orar të plotë**

1. Për punën e kryer me orar të plotë, punëtori do të merr pagën mujore sipas kategorizimit të vendeve të punës;
2. Orari i plotë i punës nuk mund të përfshijë më shumë se 40 orë në javë, java e punës është 5 ditë;
3. Organizimi i orarit të punës bëhet sipas nevojave të sektorëve përkatës;
4. Përjashtuar nga paragrafi 2 i këtij neni në rastet e jashtëzakonshme, maksimumi i orëve shtesë të punës është 8 orë në javë por jo më shumë se 20 orë në muaj;
5. Kalkulimi i pagave mujore dhe orëve shtesë, do të bëhet nga Departamenti i Financave në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës;

6. Afati i fundit për dorëzimin e evidencave të punës tek zyrtari për personel – resurse njerëzore, është data e fundit e muajit.

## **Neni 12**

### **Kompensimi për punën shtesë**

1. Puna që kalon mbi 40 orë në javë për punëtorët e Trafiku Urban konsiderohet punë jashtë orarit dhe llogaritet në shkallën e kompensimit sipas nenit 56 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212.
2. Puna jashtë orarit kërkohet me shkrim nga Eprori i drejtpërdrejtë.
3. Kërkesës për punën jashtë orarit, i bashkëngjitet arsyetimi me shkrim.
4. Vendimin për lejimin e punës jashtë orarit e merr Kryeshefi Ekzekutiv.
5. Bazat e organizimit të punës jashtë orarit janë të përcaktuara me LPK.
6. Dokumentacioni mbi lejimin e punës jashtë orarit, i dorëzohet Burimeve njerëzore pranë Drejtorisë së Administratës, bashkë me evidencën e kohës së punës.
7. Puna në ditët e Festave Zyrtare, kompensohet me pagesë shtesë në shkallën 150 % për orë pune ose me ditë të lira në shkallën e njëjtë me pagesën.
8. Përjashtuar nga paragrafi 1. i këtij neni nuk përfshihen me kompensim, oraret e rregullta të punës së natës kur puna është e organizuar me ndërrime.
9. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuarit ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.
10. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë:
  - 10.1. 20 % në orë për kujdestari;
  - 10.2. 30 % në orë për punë gjatë natës;
  - 10.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit;
  - 10.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe
  - 10.5. 50 % në orë për punë gjatë fundjavës.
11. Pagesa shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira sipas ligjit e përjashtojnë njëra tjetrën.

12. I punësuari mund të kërkojë nga punëdhënësi që në vend të pagës shtesë nga paragrafi 2. i këtij neni, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi;

13. Punëdhënësi mund të vendosë që një pjesë të punës jashtë orarit të kompensohet me ditë pushimi, në përputhje me përqindjet e parapara në paragrafin 2. të këtij neni. Kjo formë e kompensimit duhet të parashihet në Kontratën e Punës ose në Aktin e Brendshëm të kompanisë.

### **Neni 13**

#### **Kompensimet për pushimet me pagesë**

Pagesa për kohën e pushimit vjetor, pushimeve statusore (në rast të martesës së tij/saj, lindjes, dhe vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes) rregullohet sipas legjislacionit dhe akteve të brendshme në fuqi.

### **Neni 14**

#### **Komisionet për kryerje të punëve specifike**

1. Kryeshefi Ekzekutiv me vendim, themelon komisione për kryerjen e punëve të veçanta;
2. Kompensimi i komisioneve për kryerjen e punëve specifike bëhet me kompensim të ditëve apo pagesë të orëve shtesë, në rastin kur puna e komisionit nuk mund të kryhet gjatë orarit të punës bazuar në nenin 12 të kësaj Rregullore.

### **Neni 15**

#### **Kompensimi i pushimit mjekësor**

Kompensimi për pushimet mjekësore bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 59 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212.

### **Neni 16**

#### **Kompensimi i pushimit të lehonisë**

Kompensimi i pushimit të lehonisë bëhet në përputhje Ligjin Nr.03/L të Punës.

### **Neni 17**

#### **Kompensimi në rast të mungesës për shkak të pasigurisë, mbrojtjes dhe shëndetit në punë**

1. Me vendim të organit të autorizuar shtetëror ose me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv të Trafiku Urban për shkak të pasigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, i punësuari ka të drejtën e mungesës me arsye nga puna, në rastet kur vlerësohet pasiguria në punë dhe rrezikimi i shëndetit të tij/saj sipas nenit 61 të Ligjit të Punës Nr 03/L-212;

2. Gjatë mungesës së përkohshme në punë për shkak të pasigurisë në vendin e punës, të punësuarit i takon e drejta e kompensimit të pagës. Ky kompensim nuk do të jetë më i gjatë se 45 ditë gjatë një viti kalendarik.

### **Neni 18** **Udhëtimet zyrtare**

1. Udhëtimet zyrtare jashtë vendit, në shtetet fqinje ose në shtetet tjera për qëllime zyrtare dhe në interes të NPK "Trafiku Urban" Sh.A duhet të paguhet nga ana e NPK "Trafiku Urban" Sh.A.

2. Para çdo udhëtimi duhet plotësuar autorizimin për udhëtimin zyrtar. Autorizimin për udhëtime zyrtare për personelin e ndërmarrjes e aprovon Kryeshefi Ekzekutiv, për zyrtarët e lartë të ndërmarrjes Bordi i Drejtorëve, ndërsa për anëtarët e Bordit njoftohet Komisioni Komunal i Aksionerëve.

3. Mëditja për udhëtimet jashtë vendit do të paguhet në bazë të Aktit Administrativ që rregullon këtë fushë

### **Neni 19** **Kompensimi për angazhim jashtë vendit**

1. Punëtorët të cilët janë dërguar nga Trafiku Urban, jashtë vendit për të kryer punët, detyrat e punës ose shkollim në gjatësi kohore mbi 30 ditë, do të kompensohen për jetë të ndarë nga familja;

2. Vlera e kompensimit caktohet me vendim të veçantë të Kryeshefit Ekzekutiv të Trafiku Urban por nuk mund të jetë më e madhe se 50% e pagës mujore të punëtorit.

### **Neni 20** **Kompensimi gjatë suspendimit dhe largimit të përkohshëm**

1. Punëtorit i cili për shkak të shkeljeve të obligimeve të punës, i është shqiptuar suspendimi si masë parandaluese deri në vendimin definitiv të komisionit disiplinor, do të kompensohet pagesa mujore në vlerë prej 50 % të pagës bazë mujore;

2. Nëse pas përfundimit të shqyrtimit të lëndës nga komisioni disiplinor, punëtori shpallet i pafajshëm dhe lirohet nga përgjegjësia disiplinore, atij do të kompensohet pjesa e pagës e ndalur gjatë kohës së suspendimit

3. Largimi i përkohshëm nga puna nuk mund të bëhet më gjatë se 6 muaj për të cilën nuk do të kompensohet me pagë.

**Neni 21**  
**Kompensimi për mos-shfrytëzimin e pushimit vjetor**

1. Kompensimi i pushimit vjetor të pa shfrytëzuar me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës si dhe ndërprerjes së pushimit vjetor të të punësuarit për nevojat e kompanisë, i bëhet për aq ditë pushim sa i kanë mbetur pa shfrytëzuar;
2. Vlera e kompensimit të pushimit vjetor është ekuivalente me vlerën e punës ditore sipas kontratës për kohëzgjatjen e pushimit vjetor;
3. I punësuari i cili nuk e ka shfrytëzuar pushimin vjetor apo një pjesë të pushimit vjetor, ditët e mbetura të pa shfrytëzuara nga pushimi, i lejohet bartja e tyre në vitin vijues deri më 30 Qershor;

**Neni 22**  
**Kompensime të tjera**

1. Të punësuarve në Trafiku-n Urban u njihet e drejta e kompensimeve si më poshtë:
  - 1.1. Pagesa e shujtës ditore;
  - 1.2. Reprerentacioni/Trajnime/Përfaqësimi;
  - 1.3. Pagesa e përvojës së punës;
  - 1.4. Paga Jubilare e cila vlen nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore do të realizohet në këtë mënyrë:
    - 1.4.1. pasi i punësuari ka arritur 10 vite punë të pa ndërprerë në ndërmarrje;
    - 1.4.2. Kërkesa për pagë jubilarë duhet të bëhet brenda 30 ditësh nga data e përfitimit të kësaj të drejte në të kundërtën konsiderohet heqje dorë nga kjo e drejtë.

**Neni 23**  
**Kompensime të veçanta**

1. Të punësuarve të Trafik-ut Urban me propozim të Kryeshefit Ekzekutiv dhe aprovim nga Bordi i Drejtorëve, mund të ju takojnë kompensime të veçanta si më poshtë:
  - 1.1. Në rast të vdekjes së një anëtari të familjes së ngushtë;
  - 1.2. Në rast të sëmundjeve të rënda;
  - 1.3. Stimulimi në rast festash zyrtare;



1.4. Kuadrot deficitare përfitojnë në bazë të Vendimit të Qeverisë të cilat i përfshijnë edhe ndërmarrjet publike lokale;

1.5. Paga e trembëdhjetë mund të realizohet duke u bazuar në performancën financiare me vendim të Bordit të Drejtorëve.

#### **Neni 24**

#### **Kompensimi me rastin e shkuarjes në pension**

Punëtorit me rastin e mbushjes së moshës së pensionimit, Trafiku Urban i ndan një kompensim me vlerë të 3 pagave mujore të periudhës së fundit, të përcaktuar sipas nenit 77, të Ligjit të Punës Nr 03/L-212.

#### **Neni 25**

#### **Kompensimi në rastin e largimit kolektiv nga puna**

Të punësuarve të Trafiku-t Urban në rast të largimit kolektiv nga puna, u bëhet kompensimi në përputhje me nenin 76 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212.

#### **Neni 26**

#### **Reprezentacioni/Përfaqësimi**

1. Të drejtën e reprezentacionit e ka Kryeshefi Ekzekutiv, në raste të veçanta dhe Zyrtarët e Lartë të Ndërmarrjes dhe zyrtarët e tjerë, me aprovim nga Kryeshefi Ekzekutiv.

2. Lartësia e reprezentacionit/përfaqësimit:

2.1 Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes, ka të drejtën e shfrytëzimit deri në 500 € në muaj.

3. Shuma maksimale e shpenzimeve për reprezentacion/përfaqësim nuk do të tejkalojë 1% të të ardhurave bruto vjetore të ndërmarrjes.

#### **Neni 27**

#### **Shpenzimet e telefonisë mobile për Bordin e Drejtorëve dhe punonjësve të TRAFIK URBAN SH.A**

Të punësuarit në Trafikut Urban kanë të drejtë në shpenzimet e telefonisë sipas Aneksit 2 të kësaj Rregullore.

#### **Neni 28**

#### **Dispozitat përfundimtare**

1. Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë Aneksi 1 dhe Aneksi 2;

2. Në asnjë rast, dispozitat e kësaj Rregullore nuk mund të jenë më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësit, se dispozitat e Ligjit të Punës ose të Kontratës Kolektive, për sa u përket të drejtave dhe kushteve nga marrëdhënia juridike e punës;

3. Për çdo paqartësi apo konflikt të dispozitave të kësaj rregulloreje, Ligjet në fuqi dhe Statuti i Kompanisë mbizotërojnë mbi këtë rregullore. Në raste të tilla dispozitat përkatëse të kësaj rregulloreje konsiderohen të revokuara, ose ndryshuara në masën e nevojshme për eliminimin e mos përputhjes me ndonjë dispozite të Ligjeve apo Statutit të Trafikut Urban;

4. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i Drejtorëve dhe nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Bordit të Trafikut Urban.

#### **Neni 29 Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja nr. 289 të datës 30.01.2019 për pagat dhe Matrica e Pagave.

#### **Neni 30 Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit, pas aprovimit paraprak nga ana e Bordit të Drejtorëve.